

Gjuha shqipe në Universitetin e Prishtinës (botuar në "Koha Ditore" më 19 tetor 2011)

Shumë prej problemeve themelore të arsimit në Kosovë e kanë zanafillën në ndërhyrjet e politikës ditore, të nivelit qendror dhe lokal. Megjithatë, ka plot probleme që burojnë prej vetë institucioneve të arsimit. Universiteti i Prishtinës (UP), si organizimi më i madh, më me peshë dhe prijës në këtë aspekt, fatkeqësisht prin edhe për nga problemet që i vetëshkakton ose të cilave iu kontribuon qenësishëm.

Për shembull, duket e qartë që problemi i varfërisë së gjuhës shqipe të shkruar ndër studentët e UP-së, edhe pse jo ekskluziv për ta, është alarmant dhe kërkon rrugëzgjdhje të menjëhershme. Rektorati i universitetit publik në kryeqytet kohë më parë kishte dhënë propozimin që parashihte futjen e gjuhës shqipe si lëndë të obligueshme për studentët e të gjitha fakulteteve në UP. Ky thuhej të ishte çelësi i suksesit të dëshiruar në mësimin e gjuhës shqipe nga të gjithë studentët, ose *panacea* e problemit. Por, a mund të jetë ky propozim vetëm krijim i një problemi të ri që nuk e zgjidh problemin fillestar?

Paraprakisht duhet të potencohet se diskutimi publik për këtë çështje jashtë forumeve universitare – sidomos meqë në këto forume kishte munguar -- mund të jetë i vlefshëm jo vetëm për shkak të rolit që ka UP-ja në shoqërinë tonë, apo se gjuha është themeli i identitetit tonë kombëtar, apo se komunikimi i efektshëm në punë sjell përparësi ekonomike, por edhe për shkak të mësimave të përgjithshme që mund të nxjerrim nga një propozim i tillë.

Pikënisja e mësipërme e Rektoratit mund të na krijojë përshtypjen se Kosova ka kuadër të mjaftueshëm, dhe mjaftueshëm të kualifikuar, për ta ligjëruar gjuhën shqipe në UP, në secilin fakultet, por problem është se studentët deri tash nuk kanë qenë të obliguar ta studiojnë gjuhën e tyre amtare gjatë një semestri akademik. Duke e ndjekur këtë logjikë, del se në ato degë ku studentët kanë qenë të obliguar ta studiojnë gjuhën shqipe, sikurse në Fakultetin e Filologjisë, përmes një numri të madh të lëndëve në çdo semestër të studimeve të tyre, sukseset nuk duhet të kenë munguar.

E vërteta, siç e dimë, është larg këtij konkludimi. Fatkeqësisht, nëse profesorët e gjuhës shqipe nuk kanë rezultate mbresëlënëse në drejtimin e tyre në Fakultetin e Filologjisë, nuk ka arsye të besohet se ata do të ishin të suksesshëm duke shpjeguar emrat e foljet në drejtimin e ekonomisë apo të edukatës fizike.

Poashtu, një llogaritje e thjeshtë do të na tregonte se kuadri i kualifikuar, me tituj akademik të lartë, siç e kërkon mësimdhënia në UP, edhe ashtu është i munguar për një angazhim masiv afatgjatë, siç ishte ideja e Rektoratit.

Në fakt, problemi në masë të paneglizhueshme buron nga vet UP-ja: mësimdhënësit në mësimin parauniversitar në numër të konsiderueshëm rastesh tregojnë rezultate të dobëta pikërisht për shkak të cilësisë së munguar të studimeve të tyre në UP. Andaj, UP-ja do të duhej të përqëndrohet, së pari, në zgjidhjen e problemit të cilit i kontribuon vetë.

Për të mos u keqkuptuar, cilësia e munguar nuk nënkupton mungesë totale të kuadrit cilësor, por ajo gjithsesi nënkupton organizim të dobët dhe mungesë të konsiderueshme të kuadrit cilësor, siç është rasti me shumicën absolute të fakulteteve në UP.

Poashtu, duhet pranuar se problemi i zotërimit të gjuhës sonë është aq i madh sa nuk zgjidhet menjëherë ose thjesht, dhe ky problem as nuk është shkaktuar vetëm nga UP-ja e as nuk zgjidhet vetëm nga ajo. Për këtë, në radhë të parë, nevojitet një angazhim mirë i planifikuar i MASHT-it, që i nxit shkollat parauniversitare ta përkrahin mësimin e gjuhës shqipe.

Sidoqoftë, janë një sërë masash që megjithatë mund të ndërmerren nga UP-ja dhe departamentet përkatëse nëse mësimi i gjuhës shqipe, me të drejtë, konsiderohet si prioritet. Nxitja e kuadrit (cilësor), përmirësimi i hapësirave ose mjeteve të punës, tërheqja e studentëve përmes bursave, bashkëpunimi dhe përkrahja e drejtpërdrejtë e shkollave të mesme, përfshirë përmes garave e projekteve të ndryshme, janë disa prej tyre.

Një opsion shtesë do të ishte ofrimi i një lënde zgjedhore të gjuhës shqipe për studentët jashtë Filologjisë, duke e bërë këtë lëndë atraktive me ofrimin e kredive shtesë, ose ofrimin e një certificate, që do të mund të ishte e dobishme edhe për konkurrim në punë. Mos të harrojmë se komunikimi i efektshëm është esencial për shumë vende pune, andaj nuk është larg mëndësh se mjaft biznese ose institucione do ta shihnin si vlerë konkurruese një certifikatë të tillë (të fituar me meritë). Masat e mësipërme edhe do të ishin të realizueshme edhe do të prodhonin efekte pozitive.

Idetë e mësipërme i referohen një plani potencial afatmesëm dhe afatgjatë. Sigurisht se edhe studentët që aktualisht janë në UP meritojnë një mundësi që dija e tyre profesionale të mos pengohet nga një shqipe e çalë, dhe për këtë mund të organizohet një ose më shumë universitete verore ose dimërore për gjuhën shqipe, apo të fillojë viti akademik tri javë më herët, ose të mbarojë tri javë më vonë, kur gjatë asaj kohe do të ndiqej një kurs intensiv i gjuhës

shqipe. Në këtë mënyrë edhe reperkusionet financiare do të ishin më të vogla sepse nuk do të kishte ngarkesë të panevojshme afatgjate me punësim masiv për mësimdhënien e shqipes në secilin departament.

Sikurse ideja e Rektoratit, një shembull tjetër i krijimit të një problemi të ri që nuk e zgjidh problemin fillestar ishte ideja për futjen e menjëhershme të gjuhës angleze në kurrikulumin e klasës së parë të shkollave fillore. Nuk ishte bërë analizë për mungesën e kuadrit ose efektin financiar, dhe injoroheshin problemet e thella që nxënësit e klasës së parë kanë me gjuhën dhe aritmetikën. Në këtë mënyrë tentohej të tërhiqej vëmendja nga moseset. Kjo ide, e shprehur në dhjetorin e kaluar, sipas vet propozuesit, kishte si një prej synimeve kryesore reduktimin e papunësisë.

Zbutja e papunësisë, një problem jashtëzakonisht i madh në shoqërinë tonë, nuk zgjidhet as në afat të mesëm përmes masivizimit të universiteteve me studentë e ligjërues pa kriter, e as të shkollave fillore me mësues të anglishtes. Përkundrazi, kjo qasje po e dëmton seriozisht aftësinë e universiteteve për të prodhuar kuadro cilësorë, çka në të vërtetë i nevojitet ekonomisë së brishtë (së fundmi të quajtur ‘ad hoc’) të Kosovës.

la vlen të sqarohet se futja e gjuhës shqipe në çdo departament të UP-së nuk po propozohet të bëhet duke u bazuar në konceptin e ‘arteve liberale’ (moderne), ku studentët do të kompletoheshin intelektualisht dhe do të bëheshin qytetarë më të informuar, duke marrë njohuri të përgjithshme në gjuhë (të huaja), literaturë, histori, filozofi, matematikë, dhe shkencë natyrore, pa marrë parasysh drejtimet e studimeve të tyre. Ky botëkuptim në arsimin e lartë në Kosovë ende mungon dhe ka hapësirë dhe nevojë për të, në pjesë të caktuara. Por, propozimi i Rektoratit nuk i përket këtij botëkuptimi – ai vetëm përpiqet, në një mënyrë joadekuate, t’i sanojë lëshimet elementare që janë bërë në mësimin parauniversitar.

Është e pamohueshme se gjuha shqipe është problem jo vetëm në UP, por edhe jashtë saj. Sa për ilustrim, ‘baballarët’ e Kushtetutës, nuk e bëjnë dallimin në mes të diçkaje që ratifikohet ‘pas nënshkrimit...’ apo ‘...me nënshkrimin...’ (Neni 18.2 i Kushtetutës).

Përfundimisht, nëse gjuha shqipe, si një nga dy themelet e mësimin parauniversitar, është problem akut, le të fillojmë, ndër të tjera, duke e përmirësuar gjendjen në degën përkatëse në UP dhe të sigurohemi se UP-ja i kontribuon zgjidhjes së problemit e nuk shton probleme. Idetë në sipërfaqe të dobishme mund të dalin të jenë të dëmshme në afat të gjatë, e UP-ja e meriton një jetë të gjatë e të suksesshme.